



Organizata Jo-Qeveritare Rinia Aktive e Gjakovës

Youth Talk

Editorial nga aktiviteti ‘Youth Talk’ i zhvilluar me datë 19 shkurt, në Gjakovë në restaurant ‘Kulla’ me 25 të rinjë.

Komuna e Gjakovës ashtu sikurse shumica e komunave të Republikës së Kosovës, karakterizohet me numër të madhë të të rinjëve. Gjithsesi, pjesmarrja aktive e të rinjëve në jetën publike dhe proceset vendimmarrëse lë për të dëshiruar. Ndërveprimi i strukturave të përfaqësimit rinor dhe administratës komunale zhvillohet rrallë dhe atë në formate formale, kryesisht në formën e konsultimeve publike që shpeshherë nuk prodhojnë ndonjë rezultat të prekshëm.

Pasivizimi i të rinjëve është derivat i mungesës së transparencës nga ana e administratës, paqartësive dhe mungesës së informatave që të rinjtë kanë në lidhje me funksionimin e administratës komunale dhe rolit të tyre në shoqëri. Këto shkaqe prodhojnë një gjendje ku nuk ka kërkesa të adresuara nga rinia drejt administratës, as ankesa e nuk ka ndonjë proces avokimi që rezulton i sukseshëm.

Mënyra, roli dhe struktura e funksionimit të administratës komunale, ishin disa pika të përgjithshme dhe përmbajtësore për të cilat foli gjerësisht znj. Teuta Vokshi – shefe e ‘Zyra për Gjendje Civile’ si e deleguar e drejtorit të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative, zt. Nikollë Lleshi. Znj. Vokshi, si juriste, spjegoi edhe ndarjen e pushteteve dhe aspektet e ndryshme të funksionimit demokratik të administratës komunale. E pranishme ishte edhe znj. Drita Buza – asambleiste opozitare. Kjo e fundit shtjelloi mekanizmat dhe mundësitë që janë për të rinjtë që të paraqesin nevojat e tyre në formë kërkesë por edhe të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë komunale.

Në anën tjetër të rinjtë u shprehën një zëri se administrata komunale dhe asambleja nuk kanë dëshmuar që janë të vullnetshëm për përfshirjen e të rinjëve në procese konsultative e vendimmarrëse. Duke e ditur që rinia është potenciali për të ardhmen e energjia e së tashmes, ata kërkuan që të ju mundësohen kushte për shprehje të potencialit e zhvillim profesional e personal.

Nga disa të rinjë u kërkuar që administrata komunale të jetë më proaktive në ndarjen e bursave për studentët e rinjë. U theksua se duhet të krijohet një skemë e re e cila simulon të rinjtë të studiojnë profesione deficitare e të përkrahin të rinjtë që dëshirojnë të studiojnë jashtë vendit. Njihërit u kërkuar

që të rritet fondi për bursat aktuale. Për këtë u arsyetua fakti që shumica e studentëve nga Gjakova udhëtojnë më së afërmi për në Pejë, një pjesë e madhe për në Prishtinë e një pjesë tjetër për në Tiranë. Andaj, lartësia e fondit për bursa duhet të rritet proporcionalisht shpenzimeve për transport.

Në këtë temë disa nga pjesmarrësit kërkuan të dijnë më shumë se pse asambleistët nuk e kanë trajtuar këtë temë me seriozitet dhe nuk kanë ftuar takime me të rinjtë studentë. E pranishmja, znj. Drita Buza, duke theksuar se dëgjimet publike janë jo efektive dhe shpeshherë mbahen vetëm formalisht, ajo theksoi se do të angazhohet më tepër në lidhje me këtë çështje. Njiherit nga znj. Vokshi u sqaruan hapat që duhet të ndiqen nga të rinjtë në mënyrë që të jenë sa më të sukseshëm në avokim për këtë çështje.

Ky dialog i të rinjve me shefen e Zyrës për Gjendje Civile dhe përfaqësueses nga asambleja komunale në Gjakovë u organizua nga OJQ Rinia Aktive e Gjakovës në kuadër të programit “Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal” mbështetur nga organizata Nisma për të drejtat e njeriut - Kosovë (YIHR KS) dhe financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (INL).

“Ky editorialet është mundësuar me mbështetjen e YIHR KS dhe financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan (INL). Përmbajtja e këtij editorialet është përgjegjësi e plotë e OJQ Rinia Aktive e Gjakovës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL apo YIHR KS”